



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-21496/23
Kaçanik, 22.08.2023

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit 03 L/040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare 28/2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, nenit 47 i Rregullores nr. 104/01-1991/21 dhe pas propozimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunen e Kaçanikut (2024-2028)

- I. Me këtë vendim formohet grupi punues për hartimin e Planit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunen e Kaçanikut për periudhën kohore (2024-2028).
- II. Grupi punues do të ketë përbërje si në vijim:

Kryesuese e Grupit Punues-Pranverë Loku Zharku;
Zëvendës Kryesues i Grupit Punues –Agron Dema ;
Drejtorja e Administratës së Përgjithshme –Mirlinda Dema ;
Drejtorja për Buxhet dhe Financa-Muhamet Fera ,Kaltrina Luma ;
Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Arbnora Kuka;
Drejtorja për Arsimit – Gafurr Guri,Gentiana Kastrati-Sallahu;
Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport –Fatmir Qaka ;
Drejtorja për Urbanizëm , Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit –Mentor Shehu , Rufat Muça, Arditi Shehu;
Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural- Mustaf Loku;
Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë -Arian Teneqja ,Valmir Krasniqi, Eljesa Begunca ;
Zyra e Kryetarit -Ylber Bajra;
Zyra Ligjore- Ilir Lumi;
Zyra e Inspektoratit -Bujar Dullovi;
Anëtarë/e përgjegjës/e për konsultim dhe komunikim-Fatlume Guri;
Anëtarë/e të jashtëm - Hajredin Ramajli;
Anëtarë/e nga Organizatat e Shoqërisë Civile –Remzi Reka- OJQ “Gjethi “,Shpat Bulica –KVRL, Ylber Tusha –Përfaqësues i Bizneseve;
Ekspert dhe Konsulent të jashtëm ;
Zyrtarë nga Ministria përkatëse (në raste dhe tema specifike).

- III. Grupi punues obligohet që menjëherë të filloj punën .
- IV. Detyrat e anëtarëve të grupit punues janë: hulumtimi dhe analiza e gjendjes ekonomike në vend , identifikimi i problemeve socio-ekonomike , caktimi i objektivave për përmirësim të ambientit ekonomik lokal , përmbledhja e dokumenteve të rëndësishme të cilat ndikojnë në këtë dokument strategjik komunal dhe përpilimi i këtij plani në mënyrë që ky dokument në praktikë të arrijë rritjen dhe fuqizimin e zhvillimit ekonomik në komunën e Kaçanikut .
- V. Ky dokument duhet të jetë në harmoni me ligjet në fuqi të cilat zbatohen në territorin e Republikës së Kosovës , Rregulloret komunale si dhe me Planin Zhvillimor Komunal.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
- VII. Grupi punues duhet t'i përfundoj punimet në vitin 2024.
- VIII. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit.
- IX. Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit , Anëtarët e grupit punues ,dhe Arkivi.



Kryetar i Komunës
z. Besim Ilazi